UDHËZUES PËR RAPORTIM PROFESIONAL PËR EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE TERRORIZMIN

Maj, 2021

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Autorët: Dr. Marina Tuneva
Redaktor: MA Dragan Sekulovski

Ky publikim u përgatit brenda kornizës së projektit "Ndërtimi i rezistencës kundër terrorizmit të dhunshëm dhe ekstremizmit përmes kapaciteteve të përforcuara të gazetarëve, mediave dhe zyrtarëve qeveritarë", financuar nga Evropa brenda programit STREVE Global (Forcimi i Reziliencës ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm -STRIVE Global) përmes Hedayah (Qendra Ndërkombëtare e Ekselencës për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm)

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe SHGM, IEP dhe Instituti Konica dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet dhe mendimet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje 3

2. Radikalizimi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi – dallimet terminologjike 4

2.1. Radikalizimi 4

2.2. Ekstremizmi 5

2.3. Terrorizmi 5

3. Roli i mediave në raportimin mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin 6

3.1. Pse përgjegjësia e mediave është thelbësore? 6

3.2. Rekomandimet për raportim profesional dhe etik 7

3.2.1. Verifikimi i informacioneve dhe informimi përmes fakteve 7

3.2.2. Informim i ekuilibruar dhe i pavarur 9

3.2.3. Përdorimi i fjalorit dhe terminologjisë së përshtatshme 10

3.2.4. Shmangia e raportimit sensacional 11

3.2.5. Përdorimi i kontekstit të duhur 12

3.2.6. Mbrojtja e burimeve të informacioneve 13

3.2.7. Mospublikimi i informacioneve të ndjeshme dhe përmbajtjes shqetësuese dhe eksplicite 13

3.2.8. Respekt për viktimat dhe të afërmit e tyre 15

3.2.9. Raportimi për hetimet në vijim dhe proceset gjyqësore 15

3.2.10. Krijimi i hapësirës për dialog 16

3.2.11. Përdorni me kujdes i përmbajtjeve nga mediat sociale 17

1 HYRJE

Raportimi mbi terrorizmin dhe format e tjera të ekstremizmit të dhunshëm është një sfidë e madhe për mediat në të gjithë botën. Qasja te informacionet është e vështirë dhe gazetarët përballen me presion për të raportuar mbi zhvillimet në kohën e duhur. Prej tyre pritet të raportojnë për interesin publik, duke u kujdesur që të mos shkaktojnë ndonjë dëm shtesë me punën e tyre.

Mbajtja e etikës profesionale është vështirësuar, por është e pashmangshme në raportimin e ngjarjeve të tilla. Publiku ka të drejtë për informacione të sakta dhe të verifikuara, dhe media është ajo që duhet të vendosë një ekuilibër midis të drejtës për informim dhe detyrës për të respektuar normat dhe vlerat themelore të gazetarisë.

Temat e këtij lloji shpesh raportohen në një mënyrë sensacionale, përcillen deklarata që nxehin tensionet dhe ngjarjeve u jepet një konotacion etnik ose fetar. Prandaj, duhet shumë kujdes në informimin. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është që gazetarët të shmangin shërbimin e interesave të terroristëve përmes shpërndarjes së përmbajtjes grafike dhe informacioneve tepër të ndjeshme.[1] Ata duhet të shmangin, pa e ditur ose me vetëdije, tu shërbejnë autorëve të incidentit në arritjen e qëllimit të tyre për përhapjen e frikës dhe përçarjes.

Qëllimi i Udhëzuesit për raportimin profesional mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin është të ofrojë rekomandime për mediat dhe gazetarët në adresimin dhe raportimin e duhur për këto tema. Rekomandimet bazohen në parimet etike universale të pavarësisë, ekuilibrit midis lirisë së informacionit dhe përgjegjësisë në informim, saktësisë dhe përgjegjësisë në informim. Në të njëjtën kohë, supozohet se media dhe gazetarët janë një faktor i domosdoshëm i kohezionit midis grupeve të ndryshme të shoqërisë dhe luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.[2]

Shpresojmë që ky Udhëzues do të përdoret si një pikë fillestare gjatë raportimit mbi tema që lidhen me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm dhe që në të ardhmen të shërbejë për të azhurnuar kornizën etike dhe standardet etike në informimin në këtë fushë.

1 Këshilli i Evropës (2005) *Media and Terrorism – Report Committee on Culture,* Science and Education, gjendet në: https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-ViewHTML.asp?FileID=10914&lang=EN

2 OSCE (2017) *Reporting on Violent Extremism and Terrorism – Guidelines for Journalists*, gjendet në: https://www.osce.org/mission-to-bosnia-and-herzegovina/442381

2 RADIKALIZIMI, EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE TERRORIZMI – DALLIMET TERMINOLOGJIKE

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen gazetarët në raportimin mbi radikalizimin, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin është mungesa e të kuptuarit të këtyre termave. Kjo, nga ana tjetër, mund të çojë në perceptime të gabuara tek publiku. Pikërisht mediat luajnë një rol kryesor në shpjegimin e këtyre nocioneve për publikun e gjerë.

2.1. Radikalizimi

Radikalizimi ka kuptime të ndryshme në kontekste të ndryshme. Disa e përshkruajnë atë në një kuptim më të gjerë, d.m.th. si një proces përmes të cilit individët dhe grupet përcaktojnë ndryshime të gjera dhe dramatike dhe marrin hapa për të arritur ndryshime të tilla në shoqëri. Van den Bos e përkufizon radikalizimin si një proces të rritjes së vullnetit për të monitoruar dhe/ose mbështetur ndryshimet rrënjësore në shoqëri (nëse është e nevojshme dhe në një mënyrë jodemokratike), e cila është në kundërshtim me rregullimin demokratik të shtetit ose mund të përbëjë një kërcënim për të.[3]

3 Van den Bos, K. (2018) *Why people radicalize,* New York, USA: Oxford University Press

2.2. Ekstremizmi

Ekstremizmi gjithashtu ka kuptime të ndryshme. Ai përcaktohet si një kundërshtim i fortë ose aktiv i vlerave themelore, duke përfshirë demokracinë, shtetin e së drejtës, lirinë individuale dhe respektimin dhe tolerancën e feve dhe besimeve të ndryshme.[4] Ekstremizmi i referohet ideve ose veprimeve politike, fetare ose të tjera që janë ekstreme dhe jo normale, të arsyeshme ose të pranueshme për shumicën e njerëzve.[5]

Ekstremizmi i dhunshëm përcaktohet si avokim, angazhim, vullnet ose përndryshe mbështetja e dhunës së motivuar ideologjikisht ose e justifikuar për të arritur qëllime sociale, ekonomike ose politike.[6]

2.3. Terrorizmi

Ekzistojnë një numër përkufizimesh se çfarë është terrorizmi. Disa e përkufizojnë atë si "përdorimi i dhunës kundër caqeve të rastësishme civile në mënyrë që të frikësojnë ose të krijojnë një frikë të përhapur për arritjen e qëllimeve politike".[7]

Përkufizimi i terrorizmit mendohet të ketë ndryshuar me kalimin e kohës, por "qëllimet e tij politike, fetare ose ideologjike praktikisht nuk kanë ndryshuar kurrë".[8]

4 Gov.uk (2015) *Counter-extremism strategy – policy paper,* gjendet në: https://www.gov.uk/government/publications/counter-extremism-strategy

5 Oxford Learner's Dictionary, gjendet në: https://www.oxfordlearnersdictionaries.com/definition/english/extremism

6 GSDRC, https://gsdrc.org/professional-dev/violent-extremism/

7 Yonah, A., (1976). *International Terrorism: National, Regional and Global Perspectives.* New York: Praeger, p. xiv.

8 Sloan, S. (2006). *Terrorism: The Present Threat in Context.* Oxford: Berg Publishers.

3 ROLI I MEDIAVE NË RAPORTIMIN MBI EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE TERRORIZMIN

3.1. Pse përgjegjësia e mediave është thelbësore?

Media duhet t'i sigurojë publikut informacione të plota, të besueshme dhe të verifikuara. Por në rrethana kur shoqëria kërcënohet nga fenomene të tilla si terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, roli i tillë vështirësohet nga klima e frikës, panikut dhe kërcënimeve.

Megjithëse aspekti i historisë së vlefshme gazetareske luan një rol të madh në informimin, ajo që është kryesore është të shikosh përmes prizmit të etikës për tu kontrolluar kufijtë e raportimit. Nuk është e pazakontë që mediat të lejojnë që terroristët ta marrin publicitetin që ata e presin. Ekziston një sinergji midis nevojës së medias për një histori të bujshme dhe dëshirës së terroristëve për publicitet.[9]

Pjesa më e madhe e standardeve kur raportohet për këto tema bazohen në parimet themelore të punës gazetareske: saktësia, pavarësia, ekuilibri dhe përgjegjësia. Në të njëjtën kohë, gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për pasojat e raportimit të tyre dhe mënyrën se si i hartojnë këto tema, pavarësisht nga detyrimi për të qenë të përpiktë, për të përmbushur afatet dhe për të qenë

9 Matusitz, J., (2013) *Terrorism and Communication: A Critical Introduction* (London: SAGE).

objektiv. Gjithmonë duhet menduar përmes prizmit se si raportimi ndikon mbi panikun, frikën, procesin e radikalizimit dhe rrezikun e përsëritjes së akteve të tilla.

Në mënyrë që të fitojnë besimin dhe të tregojnë se po veprojnë në interes të publikut, gazetarët duhet të raportojnë jo vetëm për pasojat e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, por edhe për arsyet e ndodhjes së tyre. Kjo nënkupton jo vetëm raportimin mbi faktet ekzistuese, por edhe dhënien e kontekstit të ngjarjeve, duke respektuar parimet dhe standardet më të larta etike të profesionit.

3.2. Rekomandimet për raportim profesional dhe etik

3.2.1. Verifikimi i informacioneve dhe informimi përmes fakteve

IPërballë kërcënimeve apo sulmeve ekstremiste dhe terroriste, dezinformimi dhe spekulimet po përhapen me shpejtësi, duke rritur më tej ankthin dhe panikun në mesin e njerëzve. Gazetarët duhet të kërkojnë informacion të saktë, të paanshëm, gjithëpërfshirës, të pavarur dhe të arsyetuar. Ata duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm lidhur me përhapjen e propagandës terroriste, si dhe propagandën nga aktorë të tjerë të mundshëm. Në të njëjtën kohë, gazetarët duhet të kundërshtojnë çdo ndikim që del nga narrativët politik.[10]

Policia dhe shërbimet e sigurisë zakonisht janë burimet kryesore për sigurimin e informacioneve në kohë dhe të detajuar për publikun. Nga ana tjetër, nuk është e mjaftueshme vetëm të transmetohen informacione e marra nga institucionet, pa perspektiva shtesë dhe informacione që do të pasqyrojnë mendimin e komunitetit të ekspertëve, qytetarëve dhe burime të tjera të rëndësishme të informacioneve.

10 OSCE Mission in Kosovo (2018) *Guide for reporting on violent extremism*, gjendet në: https://www.osce.org/mission-in-kosovo/375436

Para se të pranohet pretendimi i qeverisë dhe institucioneve se kush është përgjegjës për sulmin, gazetarët duhet të hetojnë origjinën e informacionit dhe të përpiqen të sigurojnë provat e duhura. Në të njëjtën kohë, është shumë e rëndësishme t'i qasemi me kujdes pretendimeve të atyre që marrin përgjegjësinë për aktet terroriste. Ndonjëherë aktet e tilla ndodhin për motive kriminale dhe identifikohen gabimisht si sulme terroriste.[11]



Gjithashtu gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm ndaj deklaratave të ekspertëve, të cilat mund të ndikohen fuqimisht nga bindje të caktuara dhe që synojnë promovimin e agjendës së individëve ose grupeve që i mbështesin ato. Veçanërisht është e rëndësishme të mos trajtohen mendimet e ekspertëve si fakte dhe të konsultohen më shumë bashkëbisedues për shkak të ekuilibrit në raportimin dhe krahasimin e pikëpamjeve të ndryshme.

Verifikimi i pamjaftueshëm i informacioneve dhe mbështetja në supozime dhe spekulime mbart rreziqe të mëdha dhe histori të paplota. Me këtë rrezikohet interesi publik.

Disa rekomandime të dobishme:

- **Gazetarët duhet t'i shpjegojnë publikut** se çfarë informacione kanë dhe çfarë jo.
- **T'i tregojnë burimet e informacioneve,** për aq sa është e mundur.
- **Gazetarët duhet të jenë sa më transparentë që të jetë e mundur,** njëkohësisht duke treguar për kufizimet e informacioneve. Transparenca është çelësi i besimit.
- **Asnjëherë mos supozojnë për zhvillimin e mundshëm të ngjarjeve.**
- **Verifikimi i informacioneve është më i rëndësishmi.** Presioni për të informuar shpejt nuk duhet të rrezikojë të drejtën e publikut për të marrë informacione të sakta. Me rritjen e vëllimit të informacioneve më të fundit, kërkohet një verifikim i saktë i informacioneve.

11 Internews (2019) *Handbook – A conflict sensitive approach to reporting on conflict and violent extremism*, gjendet në: https://internews.org/sites/default/files/2020-01/Handbook_Reporting_Violent_Extremism_eng2020.pdf

3.2.2. Informim i ekuilibruar dhe i pavarur

Detyra për të informuar nënkupton një distancë kritike midis mediave dhe reagimeve të publikut, deklaratave dhe veprimeve të pushtetit dhe burimeve të tjera të informimit, qofshin ato parti politike nga opozita ose shoqata dhe figura publike.[12] Një qasje e tillë nuk është e lehtë duke pasur parasysh që mediat rrezikojnë të akuzohen nga publiku dhe pushteti për jo lojalitet përpara një kërcënimi të përbashkët. Por, në planin afatgjatë kjo e mbron integritetin e tyre dhe funksionin demokratik.

Gazetaria e mirë duhet të jetë e pavarur, e ekuilibruar dhe e përgjegjshme, ose më e thjeshtë:

Saktësi + pavarësi + përgjegjësi = besueshmëri.

Gazetarët duhet të raportojnë në një mënyrë të ekuilibruar dhe neutrale dhe t'i lejojnë publikut të gjykojë vetë se kush çfarë ka bërë.

12 UNESCO (2017) *Terrorism and the Media – Handbook for Journalists*, gjendet në: https://en.unesco.org/news/terrorism-and-media-handbook-journalists

3.2.3. Përdorimi i fjalorit dhe terminologjisë së përshtatshme

Fjalori duhet të jetë specifik dhe i qëndrueshëm. Ekstremizmi dhe terrorizmi janë tema të vështira dhe duhet pasur kujdes që të mos përdoret një fjalor me gjykime dhe vlerësime të vlerave. Pasojat e asaj që ka ndodhur duhet t'i përcillen publikut në një mënyrë të përshtatshme. Është e nevojshme të përdoren fjalë që përshkruajnë saktë dhe konkretisht kryesin e veprës, si "bombë vënës", "sulmues", "njeri i armatosur", "rrëmbyes", "militant", etj.[13]

Toni dhe zgjedhja e fjalëve jo vetëm që ndihmon në shmangien e panikut, por edhe në parandalimin e akteve të hakmarrjes kundër individëve dhe grupeve të cilët, sipas perceptimit të publikut, janë autorët e sulmit.[14]

Para se të raportohet për radikalizimin, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, është e nevojshme të kuptohet mirë kuptimi i tyre. Kjo do t'i mundësojë publikut t'i kuptojë ato si duhet. Ndërgjegjësimi për perceptimet e publikut dhe kontekstualizimi i duhur janë të rëndësishme për raportimin profesional dhe të pavarur.[15]



13 BBC Editorial Guidelines, Section 11: War, Terror and Emergencies – Guidelines, gjendet në: https://www.bbc.com/editorial-guidelines/guidelines/war-terror-emergencies/guidelines

14 UNESCO (2017) *Terrorism and the Media – Handbook for Journalists*, gjendet në: https://en.unesco.org/news/terrorism-and-media-handbook-journalists

15 OSCE Mission in Kosovo (2018) *Guide for reporting on violent extremism*, gjendet në: https://www.osce.org/mission-in-kosovo/375436

3.2.4. Shmangia e raportimit sensacional

Gjatë raportimit për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, mediat do të jenë jashtëzakonisht të kujdesshme dhe do të shmangin titujt sensacional dhe informacionet e paverifikuara, duke u kujdesur që të mos krijojnë ankth dhe panik shtesë në publik.

Duke vepruar kështu, mediat duhet të vlerësojnë me kujdes nëse interesi publik është më i fuqishëm në krahasim me dëmin e mundshëm që do të shkaktonin duke raportuar mbi krizën ose ngjarjen terroriste.

Në rrethana të tilla,. Mediat duhet ta marrin parasysh këtë që vijon:[16]

- **Të balancojë** proporcionalitetin midis interesit publik dhe dëmit të mundshëm
- **Të përcaktojnë** nëse shkalla e dëmit të mundshëm është më e madhe se interesi publik për vetë përmbajtjen
- **Të përcaktojnë** se çfarë është, në fakt, e nevojshme për t'i ofruar publikut një raport mjaftueshëm gjithëpërfshirës për atë që ka ndodhur
- **Të vlerësojnë** nëse përsëritja, intensiteti dhe/ose natyra shqetësuese e përmbajtjes do të shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të informuar publikun
- **Të vlerësojnë** nëse publikimi i përmbajtjes do të shkaktojë ankth dhe stres tek opinioni, familja dhe miqtë e viktimave
- **Të jenë** të kujdesshëm ndaj përmbajtjeve eksplicite vizuale dhe grafike etj.

Gjatë raportimit për terrorizmin imazhet tronditëse të vuajtjeve njerëzore dhe pamjeve të tmerrshme nuk janë të rralla. Mediat duhet ta mbrojnë publikun dhe viktimat dhe të dashurit e tyre. Ata e kanë për detyrë për publikun, por edhe atyre për të cilët informojnë.

16 Broadcasting Standards Authority (2020) *Considerations for reporting on terrorism, violent extremism and crisis events*, gjendet në: https://www.bsa.govt.nz/assets/9c2e22b0b8/BSA-Guidance-Note-on-Reporting-on-Terrorism-Short-Final.pdf

3.2.5. Përdorimi i kontekstit të duhur

Paralelisht me raportimin përmes fakteve, publiku pret analizë dhe kontekstin e duhur rreth ngjarjeve. Mediat jo vetëm që duhet të raportojnë shpejt, por gjithashtu të krijojnë kontekst dhe qartësi më të mirë në përmbajtjet që ata i vendosin. Gazetaria e mirë do të thotë informacion i thelluar, duke siguruar një pamje më të gjerë, duke shpjeguar kontekstin specifik në të cilin ndodhin ngjarjet, duke marrë parasysh pasojat e mundshme, zgjidhjet e mundshme të problemeve, etj.

Mediat duhet të përqendrohen në rrethanat dhe kontekstin në komunitetin ku raportohet dhe t'i vlerësojnë pasojat e informacioneve të publikuara, veçanërisht në kontekstin e kohezionit shoqëror.

Konteksti shpesh prezantohet mirë përmes vizualizimit të të dhënave. Gjatë përpilimi të përmbajtjeve, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit të fotove dhe/ose regjistrimeve. Përdorimi i pamjeve arkivore nga ngjarje të tjera dhe lidhja e gabuar e tyre me temën dhe kontekstin në fjalë mund të ketë pasoja të dëmshme.



3.2.6. Mbrojtja e burimeve të informacioneve

Faktor kryesor është sigurimi i pëlqimit për zbulimin e informacioneve që rezultojnë nga biseda/intervista me burimet e informacioneve. Bashkëbiseduesit duhet të dinë se si do të përdoret materiali dhe duhet të jenë në gjendje t'i vlerësojnë pasojat. Në të njëjtën kohë, duhet të kihet parasysh se njerëzit që kanë qenë të ekspozuar ndaj traumave dhe shokut mund të mos mendojnë në mënyrë racionale dhe mund të mos jenë në gjendje të japin pëlqimin.[17] Bisedat me dëshmitarët e aksidenteve dhe katastrofave, me njerëz të plagosur dhe të sëmurë, do të zhvillohen nga mediat me vëmendje, dhembshuri dhe kuptim të plotë të gjendjes fizike dhe emocionale të atyre njerëzve.

Mediat duhet të jenë veçanërisht të kujdesshme kur raportojnë për dëshmitarët e krimeve të cilëve u është dhënë statusi i dëshmitarit të mbrojtur me ligj. Detyra për të garantuar konfidencialitetin e burimeve të informacioneve nënkupton që gazetarët do të kujdesen që të mos identifikohen identitetet e tyre. Pasojat e pamaturisë mund të jenë shkatërruese.

3.2.7. Mospublikimi i informacioneve të ndjeshme dhe përmbajtjes shqetësuese dhe eksplicite

Mediat duhet të shmangin publikimin e përmbajtjeve (pamje, fotografi) që shfaqin krime dhe dhunë, përveç nëse është veçanërisht e rëndësishme për interesin publik. Në atë rast, ata do të publikojnë një paralajmërim se mund të ketë përmbajtje që mund të shqetësojë audiencën.

Në Udhëzimet redaktuese të BBC është theksuar se "gazetarët nuk duhet të zbulojnë detaje të sigurisë ose informacione të tjera të ndjeshme që mund të përdoren në një sulm.[18] Për më tepër, identitetet e individëve ose organizatave që përndryshe nuk do të rrezikoheshin si shënjestra të mundshme nuk duhet të zbulohen, përveç nëse redaksia e arsyeton atë.[19]

17 Internews (2019) *Handbook – A conflict sensitive approach to reporting on conflict and violent extremism*, gjendet në: https://internews.org/sites/default/files/2020-01/Handbook_Reporting_Violent_Extremism_eng2020.pdf

18 BBC Editorial Guidelines, Section 11: War, Terror and Emergencies – Guidelines, gjendet në: https://www.bbc.com/editorialguidelines/guidelines/war-terror-emergencies/guidelines

19 Ibid

Në rastet e rrëmbimit, marrjes së pengjeve, rrethimeve, bombardimeve dhe ngjarjeve të ngjashme, mediat duhet të sigurojnë që gjithçka që publikojnë mund të shihet dhe dëgjohet nga ata që kanë kryer aksionin, pa marrë parasysh se ku ndodhen. Mediat nuk duhet të publikojnë informacione kritike në lidhje me situatat aktuale të pengjeve nëse siguria e pengjeve nuk kërcënohet më ose ndërprerja e krizës nuk është konfirmuar nga burimet zyrtare.[20]

Ndërhyrjet policore nuk duhet të tregohen nëse janë në zhvillim e sipër.

Mediat nuk duhet të shërbejnë si një platformë për promovimin e ideve të terroristëve dhe ekstremistëve. Kërkesat e terroristëve/ekstremistëve nuk duhet të transmetohen drejtpërdrejt.

Redaksitë duhet të vlerësojnë me kujdes se si do të veprojnë me materialet që transmetohen drejtpërdrejt në rrjetet sociale. Për shembull, CNN e ka fikur mundësinë për të shfaqur automatikisht video në faqet e saj në Facebook në lidhje me sulme të caktuara terroriste dhe rregullisht paralajmëron për përmbajtje potencialisht shqetësuese.[21]

Arsyeja kryesore për të mos transmetuar skena të drejtpërdrejta të terrorizmit është shmangia e vënies së njerëzve në rrezik. Në të njëjtën kohë, kjo do të parandalojë teoricienët të marrin informacion të dobishëm në lidhje me vendosjen e forcave të sigurisë dhe masat që po merren aktualisht.

20 Benhamou, J. (2020) *What guidelines should the media follow in its coverage of terrorist acts, The International Counter-Terrorism Review* —policy paper #1 (ICTR), gjendet në: https://www.ict.org.il/images/Paper1_ThinkOutsideTheBox.pdf

21 Beckett, C. (2016) *Fanning the flames: Reporting on terror in a networked world*, Columbia Journalism School – Tow Center for Digital Journalism, Democracy Fund Voice, gjendet në: https://www.cjr.org/tow_center_reports/coverage_terrorism_social_media.php

3.2.8. Respekt për viktimat dhe të afërmit e tyre

Mediat duhet të mbajnë llogari që ta mbrojnë dinjitetin e viktimave, të familjeve të tyre dhe të personave që janë prekur nga ngjarjet traumatike.

Në aspektin etik, ekzistojnë dilema dhe shqetësime se sa e përshtatshme është t'u afrohemi njerëzve që janë në gjendje tronditjeje dhe pikëllimi të thellë. Është e natyrshme të respektohet privatësia, dhimbja dhe pikëllimi i tyre dhe t'i ndihmojmë ata në rrethana të tilla.

Lidhur me përdorimin e filmimeve të viktimave, duhet të merren parasysh këtë që vijojnë:[22]

- **Privatësia** e viktimave dhe nëse publikimi i regjistrimeve që ato tregojnë është i justifikuar nga interesi publik (p.sh. nëse interesi publik është mjaft i fortë për të justifikuar prishjen e privatësisë)?

- **Cili është qëllimi** i regjistrimeve (d.m.th. është bërë për të ofruar "informacione humanizuese dhe ndërgjegjësuese" në lidhje me atë që ka ndodhur ose është bërë për sensacionalizëm ose për të stimuluar kuriozitetin.

3.2.9. Raportimi për hetimet në vijim dhe proceset gjyqësore

Mediat nuk duhet të raportojë në një mënyrë që do ta kompromentonin drejtësinë. Roli i tyre është të parandalojnë që proceset gjyqësore të bëhen spektakle dhe të parandalojnë që terroristët të fitojnë publicitet për veprimet e tyre. Në të njëjtën kohë, mediat duhet të jetë të vetëdijshme se qeveria mund të minojë integritetin e gjyqësorit duke orkestruar një dramë për pikëzimin politik.[23]

22 Broadcasting Standards Authority (2020) *Considerations for reporting on terrorism, violent extremism and crisis events*, gjendet në: https://www.bsa.govt.nz/assets/9c2e22b0b8/BSA-Guidance-Note-on-Reporting-on-Terrorism-Short-Final.pdf

23 UNESCO (2017) *Terrorism and the Media – Handbook for Journalists*, gjendet në: https://en.unesco.org/news/terrorism-and-media-handbook-journalists

Në raportimin për procedurat hetimore dhe gjyqësore, mediat do t'i referohet informacionit nga institucionet zyrtare hetimore dhe gjyqësore, pa një qasje sensacionale ndaj informacionit. Duke vepruar kështu, ata do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë termave që përdorin për statusin e personave në procedurat që raportojnë, në mënyrë që të mos shkelin të drejtën e tyre për prezumimin e pafajësisë.[24]

Mediat nuk do të raportojnë me paragjykime dhe do të sjellin gjykata të nxituara për fajësinë e të dyshuarve, as nuk do të paragjykojnë rezultatin e procedurave gjyqësore, në mënyrë që të mos ndikojnë në organet gjyqësore dhe rrjedhën e procedurave.

3.2.10. Krijimi i hapësirës për dialog

Ekstremizmi i dhunshëm zhvillohet në rrethana të përçarjes në shoqëri dhe atje ku nuk ka dialog të mjaftueshëm. Në këtë kontekst, gazetarët mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e hapësirës për palët kundërshtare për t'u afruar dhe për të shprehur pikëpamjet e tyre.

Është veçanërisht e rëndësishme të dëgjohen mesazhet që komunitetet e marginalizuara duan t'i dërgojnë pushtetit dhe publikut. Në të njëjtën kohë, gazetarët duhet të monitorojnë nëse pushteti dhe institucionet po bëjnë ndonjë gjë për të përmirësuar situatën dhe për të adresuar nevojat e këtyre njerëzve.

Gazetarët duhet të garantojnë një përfaqësim të ekuilibruar që do të pasqyrojë kryesisht opinionet e grupit ose komunitetit, duke diversifikuar dhe rritur përfaqësimin e burimeve të informacionit.[25] Mënyra në të cilën do të bëhet kjo do të rezultojë nga analiza e mënyrës në të cilën hartohen historitë mbi këto tema, dhe veçanërisht larmia e palëve të konsultuara. Është veçanërisht e rëndësishme të merret në konsideratë ndikimi shoqëror i raportimit, jo vetëm të mendohet përmes prizmit të fakteve, statistikave dhe natyrës dramatike të ngjarjeve. Mediat gjithashtu kanë një rol ndërmjetësues në ndikimin emocional të publikut.

24 CEMM (2020) *Guidelines for ethical reporting in online media*, gjendet në: https://semm.mk/dokumenti/korisni-resursi/kodeks/850-nasoki-za-etichko-izvestuvanje-na-onlajn-mediumite

25 OSCE Mission in Kosovo (2018) *Guide for reporting on violent extremism*, gjendet në: https://www.osce.org/mission-in-kosovo/375436

3.2.11. Përdorni me kujdes i përmbajtjeve nga mediat sociale

Mediat sociale janë një nga burimet më të përdorura për informacionet në lidhje me ngjarjet terroriste. Aty shpesh raportohet terrorizmi, i cili mund të ndikojë në rrjedhën e mëtejshme të informimit. Vetë audienca ka qasje të pakufizuar dhe të drejtpërdrejtë në një sasi të madhe informacioni nga një gamë e gjerë burimesh. Publiku mund të marrë informacione direkt nga qytetarët, pushteti, madje edhe nga vetë terroristët.[26]

Në epokën e mediave sociale, të gjithë duan të jenë të parët, por nëse përmbajtja nuk verifikohet, qëllimi i publikimit të shpejtë të informacionit humbet. Ashtu siç kontrollohet përmbajtja nga burime të tjera, ashtu duhet të kontrollohen edhe mediat sociale. Ato mund të jenë një burim i vlefshëm dhe i rëndësishëm, por informacioni duhet të verifikohet dhe të futet në kontekst. Ka shumë situata në të cilat përmbajtja dhe fotot në rrjetet sociale nuk kontrollohen, mund të nxirren nga konteksti ose të krijohen me tendencë për të arritur qëllime të caktuara.

Gazetarët kanë qasje në një numër veglash për verifikimin e përmbajtjes në internet (për shembull, TinEye7, Google Reverse Image, etj.).

26 Beckett, C. (2016) *Fanning the flames: Reporting on terror in a networked world*, Columbia Journalism School – Tow Center for Digital Journalism, Democracy Fund Voice, gjendet në: https://www.cjr.org/tow_center_reports/coverage_terrorism_social_media.php

www.znm.org.mk